


“Prodhim Materiale Ndërtimi” sh.a.
Zona Industriale (ish Metalurgjiku), Elbasan

VENDIM Nr. 3
I ASAMBLESE SË JASHTËZAKONSHMË TË
AKSIONERËVE TË “P.M.N.” sh.a.


Humbjet e viteve 1997-1998 të korrigjuara me rezervën e kapitalit, të kalojnë në zvogëlim të kapitalit themeltar.

Ekspert kontabel i autorizuar për të hartuar raportin e zvogëlimit të kapitalit, çaktohet z.Ethem Sula.

Për “2K Group” sh.p.k.:
Administratori
Koço Kokëdhima



Për Ministrinë e Ekonomisë
Rozafat Shllaku



Notere:
Violeta Sulkaj

I E K A
EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR
HETEM SULAJ

PER :

SHOQERIA TREGETARE " **PRODHIM MATERIAL NDERTIMI** " SH . A .
ELBASAN

RAPORT

PER ZVOGELIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE

Ne cilesine e Ekspertit Kontabel te Autorizuar te shoqerise dhe ne zbatim te misionit te parashikuar nga neni 164 te ligjit 7638 dt. 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare " me rastin e zvogelimit te kapitalit , ne ju paraqesim raportin tone mbi projektin e zvogelimit te kapitalit .

Me shkresen nr.64 te prot. Dt.03.01.2003 , shoqeria tregetare "Prodhim Material Ndertimi " Elbasan e cila me poshte do te permendet me P.M.N , Elbasan ,ka njoftuar Ministrine e Ekonomise z.Arben Malaj ,lidhur me mbajtjen e mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve , rendin e dites,daten dhe vendin e mbledhjes.

Me shkresen 406/1 dt.23.01.2003 dhe 406/2 dt.23.01.2003 , autorizohet perfaqsesi I ME z.Rozafat Shllaku per te perfaqsuar ME ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionerve te shoqerise tregetare PMN Elbasan si dhe qendrimin e ME si zoteruese e 49% te aksioneve te shoqerise .

Ne daten 23.01.2003 , ne mbledhjen e saj Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionerve , me votim unanim , me propozim te drejtorise , eshte shprehur per zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise nepermjet pastrimit te humbjeve te trasheguara te vitit 1997 dhe 1998 pasi te jene korrigjuar me rezerven e kapitalit ne bilancin financiar te vitit 2002 .

Me vendim nr. 3 dt . 23.01.2003 Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionerve ka vendosur qe Eksperti Kontabel I Autorizuar z. Hetem SULAJ te hartoj raportin lidhur me zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise . Sa me siper shoqeria I eshte drejtuar Gjykates se Faktit Tirane , e cila me vendim nr.1769/2 dt.16.04.2003 , midis te tjerave shprehet per zvogelimin e kapitalit . Humbjet e vitit 1997 dhe 1998 te korigjuara me rezerven e kapitalit , te kalojne ne zvogelim te kapitalit themeltar .Ekspert kontabel I autorizuar per te hartuar raportin e zvogelimit te kapitalit , caktohet z.Hetem Sulaj .

Per realizimin e misionit te mesiperm jane marre ne konsiderate :

1. Shkresa nr.64 dt.03.01.2003 e PMN sh.a Elbasan drejtuar ME z.Arben Malaj .
2. Shkresa nr.406/1 dt.23.01.2003 ,Autorizim I perfaqsesit te ME.
3. Shkresa nr.406/2 dt.23.01.2003 , per qendrimin qe duhet te mbahet ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve ne SH.A " Prodhim Material Ndertimi " Elbasan , perfaqsesit te Aksionerit Shtet , te Ministrise se Ekonomise .

4. Procesverbal I mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise " P.M.N " sh.a Elbasan I dates 23.01.2003 .
5. Vendimi nr.3 dt.23.01.2003 I Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise " P.M.N " sh.a Elbasan .
- ~~6. Vendimi I gjykates se Faktit Tirane nr.1769/2 dt.16.04.2003 .~~
7. Bilanci kontabel I ushtrimit 2002 se bashku me raportin e auditimit , si bilanc I fundit I mbyllur per te pasqyruar veprimet lidhur me zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise PMN , Elbasan .
8. Bilancin kontabel te vitit 1997 dhe 1998 , raportet e auditimit si dhe qendrimin e ME per miratimet e bilanceve perkatese .

VLERESIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Ne vleresimin e kapitalit themeltar jemi bazuar ne te dhenat e bilancit financiar te vitit 2002 te ekspertuara nga Eksperti Kontabel I Autorizuar z.Andon Kristo .

ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR NEPERMJET PASTRIMIT TE HUMBJEVE .

Pasi jane realizuar humbje gjate ushtrimit , situata neto e shoqerise per tre vite paraqitet :

	<u>VITI 2002</u>	<u>VITI 1997</u>	<u>VITI 1998</u>
Totali I aktivitet	144.027.993 leke	146.313.469 leke	130.470.241 leke
<u>Detyrimet</u>	<u>55.101.656 leke</u>	<u>5.887.943 leke</u>	<u>17.672.423 leke</u>
Kapitalet e veta	88.926.337 leke	140.425.526 leke	112.797.818 leke
 Kapitali themeltar	162.000.000 leke	162.000.000 leke	162.000.000 leke
Diference rivleresimi	15.453.892 leke	20.522.827 leke	15.453.892 leke
Humbje e mbartur	- 92.927.392 leke	= leke	- 42.851.801 leke
Fitim e humbje e vitit	+ 483.660 leke	- 42.851.801 leke	-25.720.450 leke
Fonde te veta (Nd.Shtet)	734.500 leke	754.500 leke	734.500 leke
<u>Provizione per rreziqe</u>	<u>3.181.677 leke</u>	<u>= leke</u>	<u>3.181.677 leke</u>
Shuma kapitale te veta	88.926.337 leke	140.425.526 leke	112.797.818 leke

A . Efekti zvogelimit tekapitalit themeltar nepermjet pastrimit te humbjeve te vitit 1997 dhe 1998 :

Humbjet e vitit 1997	- 42.851.801 leke
<u>Humbjet e vitit 1998</u>	<u>- 25.720.450 leke</u>
Shuma e Humbjeve	- 68.572.251 leke

B .Efekti I korigjimit te kapitalit themeltar me rezervat (diferenca nga rivleresimi , fonde te veta) :

- Diference rivleresimi	15.453.892 leke
<u>Fonde te veta (Nd.Shtet)</u>	<u>734.500 leke</u>
Shuma e Rezervave	16.188.392 leke

C . Vleresimi I kapitalit themeltar nepermjet pastrimit te humbjeve te vitit 1997 dhe 1998 pas korigjimit te tyre me rezervat e kapitalit :

Kapitali themeltar	162.000.000 leke
Minus humbjet	- 68.572.251 leke
<u>Plus Rezervat</u>	<u>+ 16.188.392 leke</u>
Diferenca	109.616.141 leke , Kapitali themeltar pas pastrimit te humbjeve te vitit 1997 e 1998 e korigjuar me rezervat e kapitalit .

D . Gjendja e humbjeve dhe fitimeve te pa perfshira ne vleresimin e kapitalit themeltar :

- Humbja e akumuluar deri ne vitin 2002	= 92.927.392 leke
- <u>Humbja e vitit 1997-1998 te zbritura nga kapitali</u>	<u>= 68.572.251 leke</u>
- Diferenca qe ngelet ne bilanc(pa u mbuluar nga kapitali)	= 24.355.141 leke
- Fitimi I vitit 2002 I pasqyruar ne bilanc	= 483.660 leke
- Provizione per rreziqe	= 3.181.677 leke

Veprimet kontabile :

Per humbjet e vitit 1997 dhe 1998 ;

Debitohet llog . 101 Kapitali themeltar per 68.572.251 leke .
Kreditohet llog . 107 Humbje te trashguara per 68.572.251 leke .

Per rezervat (diferenca nga rivleresimi , fonde te veta) ;

Debitohet llog ; - Diference rivleresimi	15.453.892 leke
<u>- Fonde te veta (Nd.Shtet)</u>	<u>734.500 leke</u>
Shuma e Rezervave	16.188.392 leke
Kreditohet llog ; 101 Kapitali themeltar per	16.188.392 leke

Diferenca midis zvogelimit te kapitalit themeltar nepermjete shumes se humbjes pas korigjimit me rezervat, regjistrohet ne llogarine 104 – Prime te lidhura me kapitalin .

Veprimet kontabile :

Debitohet llog . 101 – Kapitali themeltar per 16.141 leke .
Kreditohet llog . 104 – Prime te lidhura me kapitalin per 16.141 leke .

Pas ketyre veprimeve kontabel situata pasqyrohet ;

- Kapitali themeltar me vlere te plote	109.600.000 leke .
- Prime te lidhura me kapitalin	16.141 leke .
- Humbje te akumuluar	24.355.141 leke
- Fitimi I vitit ushtrimor	483.660 leke
Kapitalet themeltar, rezervat e fitim /humbje	85.744.660 leke
Provizione per rreziqe e shpenzime	3.181.677 leke
Kapitalet e veta	88.926.337 leke

Pas zvogelimit te kapitalit themeltar , kapitalet e veta te shoqerise paraqiten si me poshte ;

Kapitalet e veta para projektit te zvogelimit 88.926.337 leke .

Kapitalet e veta pas pastrimit te humbjeve 88.926.337 leke .

RAPORTET E ZOTERIMIT TE KAPITALIT THEMELTAR PAS PROJEKTIT TE ZVOGELIMIT

Zvogelimi I kapitalit themeltar nuk cenon barazine dhe raportet e aksionerve e cila ekzistone ne keto raporte ;

- Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit zoteron $49\% \times 109.600.000 = 53.704.000$ leke te kapitalit themeltar I cili perbehet nga 53.704 aksione me vlere 1000 lek /aksioni .
- 2 K GROUP me pronar z. Koco KOKEDHIMA zoteron $51\% \times 109.600.000 = 55.896.000$ leke te kapitalit themeltar I cili perbehet nga 55.896 aksione me vlere 1000 leke/aksioni .

Ne kemi analizuar operacionet e zvogelimit te kapitalit duke kryer shqyrtimet (verifikimet) qe I kemi cmuar te nevojshme sipas normave te profesionit .

Ne jemi siguruar pikerisht qe zvogelimi nuk con shumen e kapitalit ne shifra posht minimumit te kerkuar nga ligji dhe qe operacioni nuk cenon barazine e aksionerve .

Ne nuk kemi ndonje verejtje, lidhur me shkaqet dhe kushtet e ketij operacioni I cili do te zvogeloj kapitalin themeltar te shoqerise tuaj nga 162.000.000 leke ne 109.600.000 leke .

Tirane , me 16 / 1 / 2004

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR

Hetem SULAJ

Eksp. Kont. I Autorizuar
HETEM SULAJ
TIRANE ALBANIA
NR. Lic 8/2